



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1573 prot:

Pukë, më 27 08.2024

VENDIM

Nr 36 date 16.08.2024

PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" I BASHKISË PUKË
Z. EQREM MUSLI ZENELAJ

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54, germa "m", Ligjin Nr. 94/2022 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", me propozim të një grupi këshilltarësh bashkiak dhe pas miratimit të komisionit këshillimor për dhënie të titujve vendor të nderit, Këshilli i Bashkisë Pukë, pasi u njoh me propozimin dhe me dokumentacionin e paraqitur:

Vendosi:

1. Të miratojë dhënie të titullit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë Z. Eqrem Musli Zenelaj, me këtë motivacion:

"Në vlerësim të kontributeve të pakursyera e të jashtëzakonshme në fushat e studimeve historike, akademike, arkeologjike, diplomatike e juridike për promovimin e historisë kombëtare Shqiptare-Illo-Pellazge, si dhe duke hulumtuar me pasion në 20 arkivat më të njohura dhe më të vjetra të Europës e me gjerë, për 25 vite me radhë ka botuar 14 vepra madhore, 5 prej tyre me parathenie të autoreve të njohur ndërkombëtarë, në të cilat janë prezantuar e analizuar zbulime të rralla, dokumente, fakte, harta e të dhëna të panjohura deri tani, të cilat ndriçojnë historinë kombëtare".

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Këshilli i Bashkisë, Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Miratuar me 10 vota, vota pro 10, 0 vota abstenim, 0 vota kunder

Shpallur me date 23.08.2024

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA